

SISTEMI I BASHKËTINGËLLOREVE NË TË FOLMEN SHQIPE TË PLAVËS DHE TË GUCISË

Mehmet Ahmetaj

Instituti Albanologjik
i Prishtinës

KUD 809.198.3—87
Punim studimor

Marrë për botim më 21 shtator 1987

Në këtë punim dialektologjik është bërë fjalë në mënyrë të ngjeshur rreth fillzhvillimit evolutiv të sistemit konsonantik, si dhe për një dorë të tërë formash të hershme origjinale të shqipes, që i gjejmë dendur edhe në shkrimet e autorëve tanë të vjetër të Veriut.

Me sa kemi vërejtur, sistemi konsonantik i së folmes shqipe të Plavës dhe të Gucisë me rrethina, të shumtën e herës përkon me artikulimin e mbarë sistemit bashkëtingëllor të shqipes. Por, megjithkëtë, me duket me interes të veçantë për historinë e dialektologjinsë shqiptare, që të vihet në dukje në mënyrë sa më të hollësishme fillzhvillimi evolutiv i sistemit në fjalë, duke u bërë një vështrim përgjithësues disa veçorive të hershme dialektore, që i ka ruajtur e folmja jonë sot e gjithmonë, të cilat shpeshherë i gjejmë edhe në shkrimet e shkrimtarëve tanë të Veriut.

Kështu, në të folmen e këtij skaji të arealit gjuhësor të shqipes, bashkëtingëllorja frikative grykore *h*, ruhet përgjithësisht në të gjitha pozicionet e fjalës, ashtu sikurse në mbarë të folmet e gegërishtes veriore. Këtu, bëjnë përjashtim një numër i vogël fjalësh, ku bashkëtingëllorja *-h*, në gji të fjalës, nuk dëgjohet fare, të cilat do t'i vëmë në spikamë më poshtë.

Pra, siç theksuam më sipër, bashkëtingëllorja grykore *-h*, është ruajtur pothuaj në të gjitha pozicionet e fjalës, ku sa për ilustrim po i japim një varg shembujsh.

— në fillim të fjalës: *hapi, hipi, herri, hotjānçe, hupi, hekur, hū,*

— në mes të fjalës: *betohem, ze:hem, qyhem, rrahem, rrahī:n, -a, etj.*

— në fund të fjalës: *g-juh, krah, rrah, njoh, ah, shoh, e të tjerë.*

Gjithashtu bashkëtingëllorja *-h*, ruhet mirë edhe te një numër i kufizuar fjalësh dhe emrash vetjakë të gurrës së huaj tur-

ko-arabe (orientale), rëndom në pozicion nistor dhe fundor të fjalës, si për shembull: *han, haraç, hak, hatër, hise, hile, ha:ll, Hasan, Hysen Hajdar, Ha:v, gjynah, sabah.*

Sa i përket sistemit konsonantik në të folmen e Plavës dhe të Gucisë me rrethina, kemi vërejtur se te një numër i vogël fjalësh bashkëtingëllorja frikative grykore *-h* nuk dëgjohet fare, veçanërisht në pozicion mestor të fjalës, kur ndodhet para bashkëtingëlloreve *-t, -m*, si p.sh.: *i ze:t*, (<i nxehtë), *i le:t* (<i lehtë), *nimj/dimj* (<ndihmoj), *ni:m/di:m* (<ndihmë), *letoj/lecoj* (<lehtësoj), *lenoj* (<lehtësoj), *nimc/dimc* (<ndihmës). etj.

Një dukuri të tillë, e kmi vënë re edhe në të folmen e Tuzit, të Grudës, të Hotit, të Trieshit, të Rozhajës, që shkojnë me të folmet e Malësisë së Madhe, si dhe në ligjërimet shqiptare të Kosovës. Pra, përkitazi me bjerrjen e *h-së*, te fjalët e mësipërme, sikurse ka vënë në spikamë Gj. Shkurtaj „nuk kemi të bëjmë me një rënie të *h-së*, por me trajta origjinale pa *h*. Ky mendim përforcohet edhe me faktin që fjalë të tilla dalin pa *h* që në librin e Buzukut”.¹

Në të folmen e kësaj ane, nuk mungojnë shembujt e rrallë të këmbimit të *-h-së* me *f*, veçanërisht te trajtat e foljes *ftohem*, në të gjitha mënyrat dhe kohët e saj. Këtu, sa për ilustrim të fenomenit të labializimit të *h-së* në *f*, po japim zgjedhimin e foljes *ftofem* (<*ftohem* në kohën e tashme të mënyrës dëftore të diatezës pësore-vetëvetore), p.sh. (*û*) *ftofem*, (*ti*) *ftofesh*, (*aj/ay*) *ftofet*, (*na*) *ftofem*, (*ju*) *ftofi*, (*ata/ato*) *ftohen*, etj.

Gjithashtu *h-ja* labializohet në *f* rrallëherë edhe te disa fjalë të formuara nga folja *ftofem* (<*ftohem*), si: *t'ftoftit*, *ftofci:n-a*, të cilat hasen dendur në gojën e brezit të vjetër, kur te fjala *ftofci:n-a*, kemi të bëjmë edhe me këmbimin e *s-së* në *c*, fenomen ky i shpeshtë në të folmen tonë dhe në të folmet e tjera të Malësisë së Mbishkodrës.

Ndërkaq, te folja *shoh*, nuk e kemi dëgjuar asnjë rast të labializimit të *h-së* në *f*, por kryekreje del me bashkëtingëlloren *h*. Pra, për të vënë në vështrim mbizotërimin e plotë të grykores *h*, te folja *shoh*, po japim zgjedhimin e saj në kohën e tashme të mënyrës dëftore të diatezës veprare, dhe në kohën e pakryer për shembull: (*û*) *shoh*, (*ti*) *sheh*, (*aj/ay*) *sheh*, (*na*) *shohim*, (*ju*) *shihni*, (*ata/ato*) *shohin*; (*û*) *shihkesh/shihshem*, (*ti*) *shihshe*, (*aj/ay*) *shihke/shihte*, (*na*) *shiheshim*, (*ju*) *shihshi*, (*ata/ato*) *shihshin* etj.

Këmbimi i bashkëtingëllores *h* me *f*, në të folmen e kësaj zone skajore të truallit gjuhësor të shqipes, kundrejt trajtave me *h* ka një përdorim të kufizuar. Kështu, siç është vënë në spikamë nga B. Beci „Fenomeni i labializimit të *h-së* në *f*, që është një

¹ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, DSH III, Tiranë, 1975 f. 28.

fenomen karakteristik për gegërishten, në këtë të folme ka gjetë një përhapje shumë të vogël, megjithëse është relativisht i hershëm".² Po ashtu, „Edhe te „Meshari” i Buzukut (1555) mbizotërojnë format primare me *h*. Në këtë pikë duket se Buzuku pasqyron të folmen e krahinës së tij ku fenomeni duket kishte filluar, po nuk ishte përgjithësuar”.³

Bashkëtingëlloret qiellëzore q, gj, në të folmen e këtij krahu të gjuhës shqipe, dëgjohen dhe shqiptohen rëndom të kthjellta pa kurfarë nuance afrikimi, ashtu sikurse në mbarë të folmet e Malësisë së Madhe, dhe në të folmen e Malësisë së Krajës — Brisk, Shestan. Këtu, siç theksuam më sipër, bashkëtingëllorja qiellëzore okluzive *q* shqiptohet dhe dëgjohe përgjithësisht si e tillë, në të gjitha pozicionet e fjalës, si: *qën*, *-i*, *qa:f*, *-a*, *qēlp*, *-bi*, *Qarri:sht*, *-a*, *Quku i Poshtër*, *Quku i Sirum*, *qyqan*, *qyqu:j*, *pleqni*:, *kollomoq/kollomboq*, *u poq*, *diq* etj.

Gjithashtu edhe bashkëtingëllorja qiellëzore *gj* dëgjohe e kthjellët, si p.sh.: *gjaku*, *gjeth*, *gjel*, *gjy:s*, *gja:sht*, *Gjy:l*, *Gjy:κ*, *Gjeto*, *Gjonaj*, *Gjo(n)balaj*, *Gjekaj*, *Hasangjekaj*.

Në këtë pikë vështrimi, është me interes dialektor të theksojmë se kalimi i qiellëzores okluzive *q* në afrikatën paragjuhore ç dëgjohe kryekreje vetëm te lidëza *çi* (=për që), e cila mbizotëron te brezi i vjetër dhe i mesëm. Ja disa shembuj të parë në kontekst: *s'ka nier ç i mune mu shty: me tã*, *nuk ka vajtuor ç i thrret gjã:m me tã*, *s'ka bir nãne(t) ç i e rrxon n'koqe t'shpin's*, *ã kjën trim trimat ç i s'ka di:t çã tuta*.

Është për t'u theksuar se bashkëtingëlloret qiellëzore *q, gj*, te një numër i vogël fjalësh kanë kaluar në *j*, në rrethana të caktuara fonetike, kur ndodhen para bashkëtingëlloreve *t, n*, për shembull: *shoqishojt* (<shoqishoqit), *zojt* (<zogjtë), si drejn (<i dreqin), *sjept* (<sqepët), *t'vojlit* (<të vogjëlit), *t'vojl* (<të vogjël), *plejt* (<pleqtë), *lejt* (<leqtë), *t'kujt e ve:s* (<të kuqtë e vesë), *u dojn* (<u dogjën), *u pojn* (<u poqën) etj. Pra një fenomen të tillë të kthimit të qiellëzoreve *q, gj* në *j*, e ndeshim në mbarë krahinën e Plavës dhe të Gucisë, por një përdorim më të theksuar ka në Dol dhe në Vishnjevë, sidomos te brezi i moçëm.

Fenomeni i kthimit të bashkëtingëlloreve qiellëzore *q, gj* në *j*, nuk është karakteristik vetëm për të folmen e kësaj oaze gjuhësore të shqipes, por një dukuri të tillë e ndeshim në tërë sistemin konsonantik të të folmeve të Malësisë së Madhe, e rrallëherë edhe në të ligjërimet shqiptare të Kosovës. Gjithashtu bashkëtingëlloret *q, gj*, janë kthyer në *j*, edhe në të folmen shqipe të Çamërisë, të truallit më skajor të shqipes, si: *i pajt* (<i paqtë), *mijtë* (<miqtë), *fijtë* (<fiqtë), *plejtë* (<pleqtë).⁴ Si duket, këtu

² B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH I, Tiranë, 1971, f. 280.

³ B. Beci, *po aty, punim i cit.*, f. 280.

⁴ Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, DSH I, Tiranë, 1971, f. 149.

kemi të bëjmë me një fenomen të hershëm të shqipes, i cili, del edhe në shkrimet e shkrimtarëve tanë të vjetër të Veriut.

Në rastet sporadike, në të folurit e brezit të moçëm vihet re fenomeni i sonorizimit të *q*-së në *gj*, te fjalët: gjeveria < qeveria, gjytet < qytet, gjytedz < qytezë, gjytetar < qytetar, etj., ku fjalën *gjytedz* e ndeshim edhe si emër topik në Vuthaj: si: *Gjytedza Kro-ni i Gjytedz, Rruga e Gjytedz, Livadi i Gjytedz, Būni i Gjytedz*. Kështu, një dukuri të tillë të sonorizimit të *q*-së në *gj*, e gjejmë në mbarë të folmet e Malësisë së Madhe, në të folmen shqipe të Rozhajës, si dhe në të folmen shqipe të ishullit etnolinguistik të Peshterit, që shkojnë kryesisht me të folmet e gegërishtes veri-perëndimore të Malësisë së Mbishkodrës, e pjesërisht me të folmet e gegërishtes verilindore.

Lashkëtingëllorja nj. — Ç'është e vërteta, bashkëtingëllorja qiellëzore *nj* të shumtën e herës ka evoluar në *j*, por nuk mungojnë rastet e ruajtjes së saj, te një numër i vogël fjalësh, veçanërisht në krye të fjalës, ku në pozicion mestor dhe fundor pothuajse përgjithësisht është rrafshuar në *j*. Ndërkaq, po japim një varg shembujsh sipas pozicioneve të fjalës.

nj > *s* në fillim të fjalës: *jā* (< *nja* + = *një*), *jekjo* (< *njekjo*), *jashtu* (< *njashtu*, *jetash* (< *njetash*), *jatje* (< *njatje*), *jat* (< *njat*), *jāri* (< *njari* = *njëri*), *jāra* (< *njara* = *njëra*), *jeshtu* (< *njashtu*) etj. Në këtë pikë është për t'u theksuar se trajtat në fjalë, kundrejt formave që e kanë ruajtur qiellëzoren *nj* në ballë të fjalës, kanë një përdorim më të rudhur, sidomos në Dol dhe Vishnjevë. Ja disa shembuj, ku bashkëtingëlloren qiellëzore *nj* e ndeshim si të tillë në pjesën dërrmuese të krahinës së Plavës dhe të Gucisë, si: *nja*, *njeki*, *njekjo*, *njashtu*, *njetash*, *njatje*, *njat*, *njatā*, *njāri* (< *njëri*), *njāra* (< *njëra*), *nonjāri* (< *ndonjëri*), *nonjāra* (< *ndonjëra*), *donjār* (< *ndonjëri*), *donjāra* (< *ndonjëra*), *asnjāri* (< *asnjëri*), *asnjāra* (< *asnjëra*), *kurnnāri* (< *kurnnjëri*), *kurnnjāra* (< *kurnnjëra*), *nonja/donja* (< *donjë*), *njeshtu*, *njekaq*, *njektu*, *njet*, *njesejt*, *neknyjna*, *njeknej* etj.

— *nj* > *j* në mes të fjalës *vuthjān*, *hotjān*, *gusjān/gucjān*, *plavjān*, *thethjān*, e *ējte* < *e enjte*,

nj > *j* në fund të fjalës: *kuj* (< *kunj*), *hūj* (< *hunj*), *fī*: (< *finj*), *ftoj* (< *ftonj*), *g-juj* (< *gjunj*), *pēj* (< *penj*) etj., ku herë-herë ka rënë krejtësisht, si *gjarpī* (< *gjarpinj*), *gamī* (< *kërminj*), *çapī* (< *capinj*), *bërri* (< *bërrcinj*).

Gjithashtu në këtë pikë vëzhgimi, është me interes dialektor për t'u theksuar se në të folurit e popullsisë myslimane të asimiluar të Plavës dhe të Gucisë, si banorë autokton të etnosit shqiptar në këto troje, që tashti flasin sllavisht, përkatësisht serbisht, kemi vërejtur se qiellzorja *nj*, është ruajtur rrallëherë sot e gjithë ditën te fjalët: *kunj*, *brinjë* < *brinjë*, dhe te emri topik *Kunje* < *Kunj* (= *bjeshkë*) etj., ku kemi të bëjmë me një element reliktor të

shqipes, si nënshteresë e elementit mbishtresë të etnikumit gjuhësor sundues.

Bashkëtingëlloret dh, ll. — Fenomeni i kalimit të *dh*-së në *ll*, në të folmen shqipe të Plavës dhe të Gucisë me rrethina, ka një përdorim të fosilizuar, të ngurosur në dy shembuj sporadikë, si: no:ll/to:ll (<ndodh). Por, në këtë pikë shqyrtimi të konsonantizmit në të folmen tonë, bën përjashtim katundi Dol dhe Vishnjevë, që sipas mendimit tonë, kthimi i fonemës *dh* në *ll*, në krye të fjalës dhe në pozicion mestor të saj, është një dukuri fonetike e rëndomtë, ashtu si në mbarë të folmet e krahut veriperëndimor të Malësisë së Madhe. Ja disa shembuj: i llaç gji: (<i dhashë gji), po m llëp llëpi (<po më dhemb dhëmbi), llët (<dhentë), llit (<dhitë), e lleza i gjarm t mǎth (<e dheza një zjarr të madh), zgiell, -a (<zgjedhë), elle (<edhe), llet (<dhjetë), e malle (<e madhe), i bërlân (<i bërdhanë), etj.

Nga ana tjetër, vlen të vëmë në dukje se fonema *dh* në pozicion fundor të fjalës, në të folmen e këtij skaji gjuhësor të shqipes, të shumtën e herës është shurdhuar në bashkëtingëlloren *th*, si për shembull: i mǎth<i madh, erth<erdh, vith<vidh, garth<<gardh, eth<edh, u derth ujt n'gjarm<u derdh uji në zjarr, Lugu i Mǎth<Lugu i Madh, Guri i Lugut t'Mǎth<Guri i Lugut të Madh etj.

Ç'është e vërteta, dukurinë e kthimit të *dh*-së në *ll*, në pozicion nistor, mestor, e rrallëherë në atë fundor, e kemi dëgjuar edhe në ligjërimet shqiptare të Traboinit të Moçëm, të Grudës, të Trieshit dhe të Kojës së Kuçit, që janë një vazhdimësi etnike dhe gjuhësore, e të folmeve të Malësisë së Madhe, ose të Malësisë së Mbishkodrës. Po ashtu një fenomen të tillë të kalimit të *dh*-së në *ll*, e kemi vënë re edhe në të folmen shqipe të Shtojit të Ulqinit, pikërisht te malësorët shqiptarë të fisit Kastrat dhe të fiseve të tjera të Malësisë së Madhe.

Një dukuri të tillë të shqiptimit të *ll*-së në vend të *dh*-së, e ndeshim edhe në Jug të Shqipërisë, në të folmen e Gjirokastrës, ku sipas mendimit të dialektologut tonë të rryer dhe të mirënjohur J. Gjinarit. „Duhet bërë një dallim: ndërsa në Veri shqiptojmë vetëm *ll* për *dh*: *llom* (dhomë), *ullamar* (<udha e mbarë), *i mall* (<i madh), *arlli* (<ardhi), *zgiella* (<zgjedha), në Gjirokastër dhe *ll* në vend të *dh*-së, por më shumë *dh* në vend të *ll*-së, kështu kemi: *i mall* (<i madh) etj. edhe: *modha* (<molla), *dhamba* (<llampa), *pradha* (<përralla)”.⁵

Siç është vënë në spikamë nga prof. Q. Haxhihasani „Fenomeni i kthimit të *ll*-s në *dh*, që është kaq i zakonshëm në të folmen e Gjirokastës, këtu nuk haset veçse në ndonjë rast fare të rrallë: *bandidh*, *bandidheps* (Pedersen 110); *pinallë* (Maz) *pina-*

⁵ I. Gjinarit, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1966, f. 41.

dhë (Pi).⁶ Kështu, për dallim nga të folmet e Malësisë së Madhe, ku *dh*-ja këmbehet me *ll*, në të folmen e Çamërisë, që është pika më skajore e truallit gjuhësor të shqipes, del e kundërta, ku në raste sporadike *ll*-ja kthehet në *dh*, ashtu sikurse në të folmen e Gjirokastrës.

Bashkëtingëllorja dh në një numër të vogël fjalësh kthehet në *ll*, edhe në të folmet e gegërishtes verilindore, pikërisht në të folmen e Nikaj-Mërturit,⁷ si p.sh. llall (<dhallë, me rrall, llom etj. Kështu, në një punim të veçantë, do të bëjmë fjalë, për këtë dukuri fonetike të kalimit të *dh*-së në *ll* dhe të *ll*-së në *dh*, duke e kundruar fenomenin në fjalë në mbarë të folmet dialektore të shqipes dhe në diasporën shqiptare, për t'i parë kështu kufijtë dialektorë përbrenda arealit gjuhësor të shqipes.

Te këmbimi i *dh*-së me *ll*-në, në të folmet e nëndialektit të Malësisë së Madhe, ku bën pjesë edhe e folmja jonë, si dhe në të folmen e Nikaj-Mërturit të nëndialektit të gegërishtes verilindore, kemi të bëjmë me një rregullsi apo me një dukuri fonetike të brendshme të shqipes, e jo me ndikimin e sllavishtes, përkatësisht të serbishtes. Ndërkaq, mendimin tonë rreth fenomenit të kalimit të *dh*-së në *ll*, pothuajse e bën të palëkundshëm edhe shtrirja e tij në të folmen e Gjirokastrës, ku kemi të bëjmë edhe me alternimin e *ll*-së me *dh*-në, që është i zakonshëm në këtë të folme, ashtu sikurse në të folmen e Çamërisë të truallit më skajor të shqipes. Nga, ana tjetër, edhe shtrirja gjeografike relativisht e gjerë në thellësi përbrenda truallit gjuhësor të shqipes e përforcon mendimin tonë lidhur me dukurinë në fjalë.

Bashkëtingëllorja f. Në këtë të folme, buzore-dhëmborja *f* del me një larmi trajtash, e cila, shpeshherë kur është gjendur në togjet e bashkëtingëlloreve *-fsh* dhe *-ft*, ka rënë krejtësisht, veçanërisht në Dol dhe Vishnjevë, ku një dukuri të tillë e kemi vërejtur te trajtat foljore të mënyrës dëshirore, si: *rrnosh*<*rrnofsh* (=rrofsh), *kjosh* shnosh e *mi:r*<*qofsh* shëndosh e mirë, *t'pasha* (<të pafsha), *shkosh* shnosh e *mi:r* (<*shkofsh* shëndoshë e mirë), *t'rasha* (<të rafsha), *t'pa:t* e mira (<të paftë e mira), *u gzosh* (<u gëzofsh), *u thërmosh* (<u thërmofsh), etj. Kurse në pjesën dërrmuese të krahinës së Plavës dhe të Gucisë me rrethina, bashkëtingëllorja *f* ruhet të shumtën e herës te trajtat e mësipërme të dëshirores, p.sh.: *rrnofsh*<*rrofsh*, *kjofsh*<*qofsh*, *t rafsha*<të rafsha, *u gzofsh/gxofsh*<u gëzofsh, *shkofsh*, *u thërmojsh*. Buzore-dhëmborja *f*, ka rënë krejtësisht në të folmen tonë edhe te fjalët: *mnash/mtash* (<mëndafsh), *la:sh* (<lafshë). Gjithashtu bashkëtingëllorja *f* ruhet si e tillë edhe te fjala *ko:fsh* (<kofshë), ku bën përjashtim katundi Dol dhe Vishnjevë me trajtën pa *f*, *ko:sh* (<kofshë).

⁶ Q. Haxhihasani, *po aty*, pun. i cit. f. 148.

⁷ Emil Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, në SF nr. 3, Tiranë, 1964, f. 107—147.

Asimilimi i grupit *fsh=sh* ka një shtrirje të gjerë gjeografike, duke filluar që nga fshatrat e Karadakut të Bujanovcit, Preshevës, Gjilanit, kalon nëpër të folmen e Kaçanikut, e nëpërmjet fshatrave të Ferizajt deri në rrethin e Bjeshkës e arrin deri te Nikaj-Mërtur. Ky fenomen shtrihet edhe në Theth, Kastrat, Pukë e që nuk është karakteristik edhe për Mirditën, ndërpritet në krahinat Gash, Bytyç e Tropojë.⁸

Sikurse në mbarë të folmet e Malësisë së Madhe, edhe në të folmen shqipe të Plavës dhe të Gucisë me rrethina, është i përgjithësuar kryekreje këmbimi i *f*-së me *p*-në te fjalët, që dalin me grupin *-fsh*, p.sh.: *rrapsh* (<rrafsh), *t'kuvësim rrapsh* (<të kuvendojmë rrafsh=kuvendim i shtruar), *Rrapshi i Poshtër* (<Rrafshi i Poshtëm), *Rrapshi i Sirum* (<Rrafshi i Sipërm), *Rrapshi i Dukagjinit* (<Rrafshi i Dukagjinit), *i rrapshjān* (=banor i Rrafshit të Dukagjinit), *kapsha:t*<kafshatë, *kapshim* (<kafshim)=buka e mëngjesit në Dol-Vishnjevë.

Bashkëtingëlloret th dhe f. — Në këtë të folme, të shumëtn e herës ndërdhëmborja *th* është këmbyer me buzore-dhëmboren *f*, p.sh.: *fe:ll*<thellë, *ufull*<uthull, *fellu:t*<thellut, *Pretfe:ll* top. gropëz e thellë, *i kfiellt*<kthiellt etj.

Me ndërdhëmboren *th*, në katundin Dol dhe Vishnjevë dalin fjalë *the:ll*, *thello:j*, *i kthiellt* etj., e rrallëherë edhe disa fjalë të tjera i gjejmë herë me *th*, e herë me *f*, si: *the:rr/fe:rr-a/mana-fe:rr-a*, *thmi/fmi*, *thërrni/fërrni* (=thëri). Pra, trajtat e mësipërme me ndërdhëmboren *th*, kundrejt trajtave me buzore-dhëmboren *f*, mbizotërojnë në të folmen shqipe të Plavës dhe të Gucisë, ku bën përjashtim katundi Dol dhe Vishnjevë me buzore-dhëmboren *f*, por jo në të gjitha rastet.

Si duket, në të folmen e kësaj treve anësore, fjala *fëmijë* del gjithmonë me ndërdhëmboren *th*, e në raste sporadike me *f*, ku forma me *th* është mbizotëruese në mbarë të folmet e gegërishtes veriore. Këtu, sipas mendimit të drejtë të prof. L. Mulakut dhe M. Bardhit „ndërrimi i tingullit *th* në *f* në këtë fjalë është shumë i ri, i një kohe shumë të vonë”.⁹

Bashkëtingëlloret r dhe rr. — Sa u përket këtyre bashkëtingëlloreve, vlen të theksojmë se ruhen gjithnjë si të tilla, në të gjitha pozicionet e fjalës, p.sh.: *rē:-ja*, *ropa*, *rā:n-a*, *lerth*, *çërmoj*, *shtri:g-a*, *va:rr-a*, *hi:rr-a*, *barr-a* etj. Kështu, nga shembujt që u thanë më sipër, mund të vihet re mirëfilli se bashkëtingëlloret në fjalë, nuk kanë pësuar kurrfarë ndryshimi dhe si të tilla përkojnë pothuajse përgjithësisht, krejtësisht me gjuhën letrare.

⁸ I. Gjinar, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSH, SSHSH, 4, Tiranë, 1963, f. 179.

⁹ L. Mulaku — M. Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, SGJD, Prishtinë 1978, f. 294.

Ndërkaq, në sistemin e konsonantizmit të së folmes të këtij trualli skajor të shqipes dalin me interes dialektor, për fonetikën historike të shqipes, edhe ndërrimet apo alternimet e bashkëtingëllore sh në ç, s në c dhe m në p. Fenomeni i ndërrimit të sh-së në ç mund të kundrohët në funksion parashtesor të fjalës dhe në të gjitha pozicionet e tjera të saj, si p.sh.: *çpërdaj, çthuri, çprishi, çpordhi, çpaloj, çpotis, çnuki/çtuki, çpotis, çpejt, çtohem, çartem, djelmoça, muç me shkua, djaloç, dhaç/llaç, thaç/laç, gjumaç, kjeç* etj.

Është për t'u theksuar se trajtat e foljeve të aoristit sigma-tik dalin kryesisht në Dol dhe Vishnjevë, të cilat kanë një përdorim të kufizuar kundrejt formave me *sh*, si: *dhash, thash, lash*, që kanë një përdorim përgjithësues në tërë krahinën e Plavës dhe të Gucisë. Gjithashtu folja ndihmëse *jam* në kohën e kryer të thjeshtë, në vetën e parë njëjës në pozicion fundor del me tingullin ç, në Dol dhe Vishnjevë, për shembull: *kjeç*. Kurse trajta me *sh*: *kjesh*, ka një përdorim pothuajse përgjithësues në të folmen e kësaj treve.

Në raste të shpeshta edhe spirantja s është kthyer në c te fjalët *nimc/dimc* (<ndihmës), *lypc* (<lypës), *lapc* (<lapës), *zānc* (<nxënës), *gu:r çkrepce* (<gur shkrepse), *āmēlci:n* (<ām-bēlsinë=ēmbēlsirë), *tharpci:n* (<thartësinë), *egērci:n* (<egërsinë), *komicioni/komicija* (<komisioni), *lagci:n* (<lagsinë=lagsirë), *fjalc* (<fjalës), *ci:ll* (<sillë), *Guci* (<Gusi), *mlojci/blojci i djepit* (<mbulojsi i djepit), *hupc* (<humbës), *malcor* (<malësor), *malci* (<malësi), *pshtjellc* (<mbeshtjellës), etj.

Po ashtu në sistemin e konsonantizmit të së folmes shqipe të Plavës dhe të Gucisë me rrethina, më duket me interes të veçantë për dialektologjinë shqiptare, alternimi i bilabiales *m* në *p*, si p.sh.: *psoj* (<mësoj), *me psua/me psuo* (<me mësue), *ā psua keq* (<āsht=është mësue keq), *kā(=kam) tie ç i po pso:jn thmija ta:j mi:r* (<kam ndie që po mësojnë fëmija e juaj mirë), *psuas/psuos* (<mësues), *psyj* (<mësyj), *pshili sy:t* (<mshili=mbylli sytë) *pshile derën* (<mshile=mbylle derën), *pshoj* (<mëshoj), *pshoj kre:s* (<mëshoj kokës).

Nga shembujt e mësipërm, del se trajta foljore *psoj* me rrjedhojat e saj, në të folmen e kësaj treve, e ruan fizionominë e vjetër, ashtu sikurse në shkrimet e shkrimtarëve tanë të vjetër të Veriut. Pra, sa për argumentim, po japim formën *psoj* në krahasim me trajtat që dalin te shkrimtarët në fjalë. „Nga autorët e vjetër Buzuku ka *mpsonj*: Nd atë mot... vote Jezu ndë klishë e *mpson*. Me *mp*-nis fjala edhe te Bogdani: të panjefuna kafshë gjithë herë tue *mpsuem*, me *mb*- te Bardhi: Me *mbsuem*. Te mbëssoj ka asimilim *mp:mb*”.¹⁰ Këtu, te trajtat *p psoj* e së folmes së

¹⁰ E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1976, f. 347—348.

Plavës dhe të Gucisë, krahasuar me shembujt e mësipërm, del se me kalimin e kohës ka rënë *m*-ja në pozicion nistor.

Në punimin tonë ,veç këmbimeve, rënieve dhe shtesave relativisht të shpeshta, që dalin nga sistemi i konsonantizmit të së folmes shqipe të Plavës dhe të Gucisë me rethina, mund të vihen re edhe një dorë e tërë trajtash origjinale të hershme të shqipes.

Mehmet Ahmetaj

LE SYSTEME CONSONNANTIQUE DU PARLER ALBANAIS DE PLAVE ET DE GUCIE

R é s u m é

Le système consonnantique du parler albanais de Plave et de Gucie avec leurs environs, dans la plupart des cas, concorde avec l'articulation générale du système de l'albanais. Toutefois, il est particulièrement intéressant pour la dialectologie albanaise de mettre en relief le plus distinctement possible l'évolution du système en question par l'observation générale de quelques particularités dialectales que l'on rencontre souvent dans les oeuvres de nos anciens écrivains du Nord.

La consonne fricative gutturale *h* dans cette contrée de l'aréal albanais est généralement conservée dans toutes les positions du mot, sauf dans un petit nombre de mots où le *h* n'est pas prononcé au milieu du mot, lorsqu'il est suivi des consonnes *-t, -n* : *i ze:t* (<*i nxehtë*), *i le:t* (<*i lehtë*), *le-noj* (<*lehtësoj*), etc. Dans quelques cas, nous avons observé que la fricative gutturale *h* est remplacée par la labio-dentale *f*, en particulier dans les formes du verbes *ftohem* dans tous les modes et temps. Pour illustrer ce phénomène de la labialisation du *h* en *f*, nous donnons l'exemple de la conjugaison du verbe *ftofem* (<*ftohem*) au présent de l'indicatif, à la voie pronominale: (u) *ftohem*, (ti) *ftofesh*, (aj/ay) *ftofet*, (ju) *ftofi*, (ata, ato) *ftofen*.

Les consonnes palatales *q, gj* sont prononcées bien clairement, sans nuance d'affrication, dans toutes les positions du mot. Ainsi, la palatale occlusive est passé à la fricative antélabiale: *ç* que dans la conjonction *çi* (à la place de *që*) qui est présent chez la vieille et moyenne génération. Exemple: *s'ka nier ç i mUNET me shty: me tã, nuk ka vajtuor ç i thre gjã:m me tã*, etc. De même, il faut souligner que les palatales occlusives *q, gj* sont passées à *j* dans un petit nombre de mots, en particulier devant les consonnes *t, n* : *zojt* (<*zogjtë*), *plejt* (<*pleqtë*), *si drejn* (<*si dreqin, u pojn* (<*u poqën*) etc.

Cependant, la palatale *nj* a l e plus souvent évolué en *j*, mais elle est conservée dans un petit nombre de mots, en particulier en début de mot, ex: *nja, njeky, njekjo, njetash, njeta*.

Les consonnes dh, ll. — le passage de *dh* en *ll*, dans ce parler, a une utilisation fossilisée dans deux exemples, à l'exception des village Pol et Vishnjeve où il est d'utilisation plus généralisée, surtout en position initiale où à l'intérieur du mot et rarement à la fin, exemple: *i llaç gjë* (<*i dhashë gjë*), *po m llep llapi* (<*po më dhemb dhëmbi*), *zgiell* (<*zgjedh*), etc.; nous pensons qu'il s'agit là d'une règle ou d'un phénomène interne de l'albanais qui est commun dans tout le parler de la Grande Malësi, et non pas d'une influence du slave, respectivement du serbe.

La labio-dentale, *f*, dans les groupes consonnantiques *fsh* et *ft* est conservée intacte dans les formes verbales du mode optatif: *rrnofsh* *rrofsh*, *kjofsh* *qofsh*, *shkofsh*, etc., formes qui ont complètement disparues à Dol et Vishnjeve. Ainsi, la consonne *f* est souvent remplacée par *p* dans les mots contenant le groupe *fsh*, par exemple: *rrapsh* (<*rrafsh*), *kapshatë* (<*kafshatë*), etc.

De même, les changements ou les alternations des consonnes *sh* en *ç*, de *s* en *c* et de *m* en *p* sont d'un intérêt particulier pour le système du consonnantisme du parler de cette contrée marginale de l'albanais. Nous donnons quelques exemples en guise d'illustration: *çpërdaj* <*shpërdaj*, *çpaloj* <*shpaloj*, *djaloc* <*djalosh*, *nimc/dimc* (<*ndihmës*), *zanc* (<*nxënës*), *cill* (<*sillë*), *pshoj* (<*mëshoj*), *pshile* (<*mshile*), *psyj* (<*mësyj*), etc.

En plus des échanges, des chutes et des apports fréquents, le système consonnantique du parler albanais de Plave et de Guçie a aussi conservé toute une série de formes originales datant de l'ancienne période de l'albanais.